

INFORMATIVE

Shkolla jonë mirëpriti delegacionin arsimor nga Afganistani e Kanadaja

Më 25 nëntor 2014, shkollën tonë e vizitoi një delegacion prej 25 mysafirëve nga Afganistani dhe Kanadaja. Vizitorët ishin mësimdhënës dhe udhëheqës të sektorëve të ndryshëm të arsimit në shtetet e tyre, prandaj edhe kishin shprehur dëshirën të shohin një shkollë model të mësimdhënies inovative në Kosovë.



**NJË FILLIM
NDRYSHE**

**DITA
E SHKRIM
LEXIMIT**

URIME 28 NËNTORIN!



Për nder të Ditës së Flamurit, 28 Nëntorit, nxënësit e shkollës "Mileniumi i Tretë" zhvilluan aktivitete të ndryshme. Thurën vargje, shkruan ese, vallëzuan, recituan, kënduan...



Shkolla jonë mirëpriti delegacionin arsimor nga Afganistani e Kanadaja



Sot, më 25 nëntor 2014, shkollën tonë e vizitoi një delegacion prej 25 mysafirëve nga Afganistani dhe Kanadaja. Vizitorët ishin mësimdhënës dhe udhëheqës të sektorëve të ndryshëm të arsimit në shtetet e tyre, prandaj edhe kishin shprehur dëshirën të shohin një shkollë model të mësimdhënies inovative në Kosovë.



Znj. Afrorë Lila, drejtoreshë e shkollës, e shoqëruar nga zv. drejtoresha dhe udhëheqësit e departamenteve priti delegacionin, të cilit i mbajti një prezantim mbi zhvillimin e shkollës ndër vite, pikat e forta të shkollës, vështirësitë dhe metodologjinë e punës në shkollë duke sqaruar qasjen inovative dhe të veçantat që e bëjnë shkollën të dalluar nga shkollat e tjera. Interesimi i vizitorëve u përqendrua në testet e jashtme që aplikohen në shkollë, vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, ditarin on-line, aktivitetet jashtë mësimore, etj.



Vizitorët, po ashtu, patën rastin të shohin edhe disa nga klasat dhe kabinetet e shkollës si dhe patën mundësinë të bisedojnë edhe me ndonjë nga nxënësit e shkollës, gjatë vizitës nëpër klasa.

Dita Ndërkombëtare e Shkrim-Leximit

Edhe në shkollën tonë më 8 shtator, u shënuar Dita Ndërkombëtare e Shkrim-Leximit. Gjatë kësaj dite u organizuan aktivitete të ndryshme lidhur me këtë ditë, duke ia përkujtuar nxënësve se cfarë rëndësie të madhe kanë shkrimi dhe leximi në jetën e individit dhe të gjithë shoqërisë. Disa nxënës vizituan Panairin e Librit për fëmijë, ndërkohë që nxënës të tjerë me mjaft interes ndoqën fjalën e të ftuarit special për nder të kësaj dite, publicistit, gazetarit dhe shkrimtarit, **Bajram Sefaj**.



Ai para nxënësve shpalosi kujtime nga përvoja e tij jetësore në fushë të krijimtarisë letrare dhe asaj gazetareske.

NJË FILLIM NDRYSHË

Bashkë me emocionet dhe mallin që nxënësit dhe mësimmshënësit ndjenin atë ditë erdhi edhe një fillim i ri për Mileniumin e Tretë. Ky vit shkollor në shkollën tonë filloi më ndryshe se vitet e tjera, duke organizuar *Lojën e stacioneve* e cila jo vetëm përmes argëtimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete iu ofronte nxënësve një mundësi për të bashkpunuar dhe njohur njëri-tjetrit, por edhe të jepte ndjesinë se ky vit do të jetë shumë i vecantë.



Gjatë këtyre dy orëve nxënësit patën rast të punojnë në grupe dhe të vizitojnë stacionet e ndryshme të cilat udhëhiqeshin nga mësimmshënësit e shkollës.

Të gjithë nxënësit pa dallim moshe apo klase u shpërndanën të gjitha ambientet e shkollës duke qeshur e duke luajtur, përfshirë edhe stafin që gjithmonë janë të gatshëm që t'i ndihmojnë e t'i mbështesin nxënësit.


Në realizimin sa më të mirë të kësaj dite morën pjesë edhe disa nga nxënësit e gjeneratave të mëhershme të cilët i falënderojmë shumë për gatishmërinë e përhershme lidhur me aktivitetet që ndodhin në shkollë.



Java e Mësimit të Bazuar në Projekte



Si çdo vjet në shkollën tonë mbahet një javë mësimore tërësisht e bazuar në projekte. Të gjithë nxënësit e shkollës që nga më të vegjlit e deri te maturantët ishin të përfshirë në tema të ndryshme. Gjatë tërë javës ata treguan interesim dhe me shumë dëshirë e të entuziazmuar realizuan kërkesat e mësimeve. Disa duke hulumtuar, disa duke lexuar e shkruar, të tjerë duke vizatuar e disa të tjerë duke gëllqerësuar e ngjyrosur edhe muret e shndërruan shkollën në një organizatë të vërtetë të të nxënies të thellë.



Si rezultat i kësaj jave u hap poashtu edhe ekspozita përfundimtare e Javës së Projekteve e cila më së miri e pasqyron gjithë punën e bërë. Këndi i kabineteve duket tejet joshës me vizatimet e shenjatat në mure që të shtojnë ta duash mësimin e ligjeve të fizikës, biologjisë e kimisë, ta dashurosh informatikën e robotikën, e të mos kërkesosh ta ulin zërin e muzikës.



Nxënësit tanë mësuan edhe kriteret që vendi ynë duhet t'i plotësojë për të hyrë në Bashkimin Evropian poashtu edhe si vepron Bashkimi Evropian. Të tjerë mësuan se si bëhet paketimi dhe fabrikimi i lëngjeve, disa të tjerë zunë vend në Hapësirën për shumë qëllime për të bërë Yoga e disa të tjerë na treguan se çka është prerja dhe raporti i artë. Një grup tjetër nxënësish na paraqitën gjeometrinë kaotike të Prishtinës, ndërsa një tjetër grup na e mësuan lëvizjen me moton "Pay it forward". Madje u analizuan edhe libra që ndër vite kanë qene të cilësuar si "të ndaluar" e për arsye të ndryshme edhe janë djegur. U realizuan edhe filma të shkurtë kushtuar njerëzve me nevojë të

veçanta. U realizuan kampanja kundër duhanit e drogës, e ndër të tjera disa na treguan edhe mënyra për lirim e stresit.

Në një nga projektet nxënësit patën mundësinë të praktikojnë edhe aktivitete meditimi nën tingujt e muzikës relaksuese, e nxënësit e një projekti tjetër kanë bërë eksperiment me një numër të madh nxënësish e mësimitdhënësish për të parë nëse muzika ndikon në të mbajturit në mend, d.m.th. A memorizohen gjërat më mire me muzikë apo pa të.

Të tjerë na treguan se thyerja e rrezeve të diellit mund të bëjë mrekullia.

Fëmijët e klasave të ulëta na treguan se krahas të drejtave i kemi edhe përgjegjësitë. Disa të tjerë udhëtuan bashkë me personazhet e tyre të preferuar të librave e filmave. Disa realizuan teatrin e kukullave e disa i dramatizuan përrallat. Nxënës të tjerë bënë analiza bukur e të thella të tregimeve e poezive të tyre. Pati ndër ta edhe të tillë që i numëruan të gjitha festat të cilat zakonisht i festojmë e disa na, mësuan për trafikun ajror, rrugor e ujor. Mos të harrojmë të përmendim edhe ata të cilët gjatë këtyre ditëve udhëtuan nëpër botën shtazore. Nxënësit e klasave të pesta filluan të shpalosin idetë e tyre për projektin “Kosovizion”.



Meqë shumica e projekteve të ciklit të ulët kishin të bëjnë me përrallat, nxënësit e këtij cikli i përmbyllën projektet me shfaqjen teatrale “Goni trazovaçi” të cilën e shikuan në teatrin “Dodona”, ndërsa nxënëset e gjimnazit morën pjesë në “Marshin” kundër kancerit të gjirit në sheshin e Prishtinës i cili u shënua si përmbyllje e muajit të vetëdijesimit kundër kësaj sëmundjeje.



Gjatë kësaj jave u organizua edhe Turneu Sportiv i Futbollit dhe Basketbollit, si dhe lojërat stafetore.

Vetëdijesimi për kancer të gjirit



Sensibilizimi intensiv në ndihmë të gruas përgjatë gjithë muajit tetor, është kurorëzuar me mbajtjen e ligjeratës nga Doktor Ekrem Hyseni – onkolog nga Klinika e Onkologjisë në QKUK i cili ishte moderator i kësaj konference, theksoi rëndësinë e përhapjes së informacionit lidhur me këtë sëmundje në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i vajzave për kryerjen në kohë të vizitave, që është në interes të gjithë shoqërisë.

Pas ligjeratës pati pyetje dhe diskutim të hapur se si mund të parandalohet një sëmundje e tillë, shpesh me pasoja të rënda.

Ligjërata vetëdijesuese kundër përdorimit të lëndëve narkotike

Më datën 23 tetor 2014, në kuadër të lëndës “Innovation & Creativity” u realizua një ligjërata vetëdijesuese nga përfaqësuesit e OJQ-së “Labyrinth” të cilët prezantuan para më shumë se 50 nxënësve të shkollës “Mileniumi i Tretë” mbi rrezikun e përdorimit të drogës.

Znj. Elin Zeneli, punëtore sociale dhe Z. Vigan Behluli, psikolog klinik, shpalosën para nxënësve të interesuar një historik të shkurtër mbi organizatën Labyrinth, ndikimin që ka në organizëm përdorimi i substancave të vartësisë si dhe ofruan një gamë të aktiviteteve që të rinjtë mund t’i ndërmarrin me qëllim të parandalimit të përdorimit të drogës.

Gjatë prezantimit u shpalosën edhe mënyrat se si të rinjtë mund të ndihmojnë në vetëdijësimin e moshatarëve të tyre që të mos bien pre e përdorimit të substancave të vartësisë ndaj substancave.

Nxënësit me interesim të veçantë e përcollën prezantimin i cili zgjati 1 orë e gjysmë. Përgjatë tërë kohës, nxënësit parashtruan pyetje dhe komente lidhur me temën e prezantuar.



Aktivitet humanitar për familjet në nevojë

Edhe këtë vit u bë zgjedhja e kryesisë së re të Parlamentit të Nxënësve të shkollës sonë, kryetare e së cilës u zgjodh me shumicë votash, nxënësja e klasës 12—1, Andra Dauti. Pikërisht, më datën e njëjtë, 1. 10. 2014 dhe në prag të festës së Kurban Bajramit, doli nisma e parë qëllimshme nga parlamenti i nxënësve për të qenë solidarë me familjet e varfra.

Së bashku me ndihmën e mësimdhënësës së Edukatës Qytetare, Lumnie Behrami, nxënësit përmes njoftimit nëpër klasa u nisën nga vullneti i mirë duke sjellë rroba, këpucë të pashfrytëzuara dhe ushqime, që nuk prishen lehtë dhe që janë të nevojshme për nevoja ditore si mielli, vaji, kripa, sheqeri, fasulja e produkte të tjera.

Në këtë aktivitet humanitar ndihmuan edhe mësimdhënësit e shkollës. Kësaj here u ndihmuan dy familje, njëra nga Kodra e Trimave në Prishtinë me katër anëtarë dhe tjetra nga Podujeva me 23 anëtarë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte solidarizimi dhe të qenit më afër me familjet e varfra dhe vetëdijesimi i nxënësve për kushtet e rënda që kanë moshatarët e tyre dhe e drejta, që ata duhet ta gëzojnë dhe të shprehin për një jetë më të mirë.



Të respektojmë të moshuarit!

Në mënyrë humanitare dhe me qëllim që të mos harrojmë dhe të jemi falenderues për të moshuarit, në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve, nxënësit e shkollës tonë "Mileniumi i Tretë" vizituan shtëpinë e të moshuarve në Prishtinë, nismë e cila u përcoll edhe nga mësimdhënësit. Nxënësit të cilët kishin grumbulluar edhe fonde blenë edhe disa dhurata simbolike për të moshuarit.

Vizita u realizua në mënyrë mjaft të rregullt dhe të organizuar. Të gjitha dhuratat u shpërndanë me dashuri dhe respekt ndaj të gjithë të moshuarve, që ndodheshin aty.




Ne të gjithë si iniciatorë dhe vizitorë mësuam shumë nga kjo vizitë, përveç që treguam anën tonë humane, ne gjithashtu kuptuam edhe anën e tyre të mirë si dhe kuptuam që një ditë edhe ne do të jemi të moshuar dhe çfarë kënaqësie shpirtërore përjeton kur ndihmon dhe je afër njerëzve që kanë nevojë.


Dita botërore e vezëve, aktivitete në shkollën tonë

Dita Botërore e Vezës festohet çdo vit, të premten e dytë të muajit tetor. Edhe shkolla jonë në këtë ditë, si edhe në shumë vende të botës, vendosi të organizojë aktivitete të ndryshme për të shënuar vlerat ushqyese që kanë vezët.


Që nga ora e parë, mësimdhënësit, në orët mësimore ndërlikohen aktivitete të ndryshme për promovimin e vlerave ushqyese të vezëve, d.m.th. funksion të kësaj teme.



Ekspozitë në lëndën e historisë dhe të gjeografisë



Arsimtarja e gjeografisë Zymryte Avdiu dhe arsimtarja e historisë Alketa Hasani kanë marrë nismë për të bërë një ekspozitë me punime të ndryshme nga nxënësit. Nxënësit punuan hamera siç dinë ata më së miri dhe në fund bënë ekspozitën që ndodhet në Hapsirën për shumë qëllime në shkollë. Punime të tilla u japin bukuri mureve e hapësirave të shkollës.



Vizita në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”

Nxënësit e klasave të treta dhe klasa IV-3, në kuadër të temës së projekteve modulare “Mjetet e komunikacionit”, vizituan aeroportin ndërkombëtar.

Nxënësit u njoftuan me procedurat që duhet të respektojnë pasagjerët e këtij aeroporti, po ashtu ata panë për së afërmi punën e punonjësve të këtij institucioni. Ishte kënaqësi për fëmijët të takojnë njerëz me profesione të ndryshme. Emocionet ishin te papërshkrueshme në çastin kur nga afër shikuan aterimin e aeroplanit.

Falenderojmë znj. Valentina Gara dhe stafin e aeroportit që na pritën ngrohtësisht dhe na informuan lidhur me punët e tyre ditore. Një falenderim të veçantë për prindin e klasës III-2, znj. Burçin Haskuka, për organizimin e vizitës.



Vizita në Bibliotekën Kombëtare

Klasat e dyta në kuadër të temës mujore, vizituan Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës . Gjatë kësaj vizite, nxënësit patën rastin të njihen me ambientin fizik të një biblioteke universitare, me mënyrën e anëtarësimit dhe me rregullat që duhet patjetër t'u përmbahemi që nga momenti kur futemi në bibliotekë si dhe me pasurinë e bibliotekës.

Me qetësi dhe me kureshtje të madhe ata vizituan sallën e leximit, ku panë shumë studentë duke lexuar, vizituan gjithashtu edhe amfiteatrin e bibliotekës në të cilin mbahen promovimet e shumë librave.

Nxënësit treguan për librat e fundit që kanë lexuar, si dhe bënë shumë pyetje të cilave iu përgjigj me shumë dashuri zonja Zylfije Rexhepi, informatore në departamentin e informacionit të BKK-së.



Vizita në Programin Zhvillimor të Kombeve të bashkuara (UNDP-në)

Nxënësit e klasës VII-2 bënë një vizitë të këndshme në njësinë kryesore të Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP) që gjendet në Prishtinë. Kjo ndodhi në kuadër të bashkpunimit me prindër dhe ftesën e prindit të klasës znj. Marta Gazideda. Nxënësit shumë të entuziasmuar vizituan vendin ku u informuan me rolin e njësive të veçanta nga prindi që e bëri të mundur këtë vizitë, pastaj u nxënësit u takuan edhe me përfaqësuesin e UNDP-së në Kosovë, z. Andreë Rusell. Nxënësit shumë kurreshtar gjatë kësaj vizite i shtruan pyetje z. Rusell, i cili i informoi për projektet dhe rolin e UNDP-së si dhe historikun e këtij institucioni. Pastaj nxënësit morrën pjesë në një mini-punëori dhe disa aktivitete të tjera në të cillat nxënësit ishin pjesëmarrës aktivë duke shfaqur rolin e tyre në shkollë dhe ndryshimet që mund të bëjnë ta përmes kërkesave të arsyeshme dhe duke përgaditur një plan të punës për zgjidhjen e problemeve dhe organizimin e aktiviteteve.



GËZUAR 28 NËNTORIN!



28 Nëntori, kjo ditë e bekuar dhe e shënuar për të gjithë ne ka qenë dhe mbetet simbol i bashkimit, unitetit, lidhjes, krenarisë, qëndresës dhe vendosmërisë së popullit shqiptar. Kjo është një ndër ditët më të ndritshme dhe ndër më të rëndësishmet në gjithë historinë tonë. Liria e arritur është vlera jonë dhe pasuria më e çmuar e shoqërisë sonë, e cila nuk falet e as nuk dhurohet, por fitohet me shumë punë e përpjekje, gjak dhe vuajtje brezash. Po këtë ditë është edhe datëlindja e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari dhe daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këto janë ngjarje që i dhanë shpirt historisë sonë. Festat e nëntorit janë festat e krenarisë sonë kombëtare, të cilat na dhanë forcë e kurajë për rilindjen e shtetit. Në këtë ditë të shënuar u përkulemi të gjithë atyre që luftuan dhe flijuan veten për lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë. Pra, urime Dita e Flamurit, 28 Nëntori.

Donita & Arta

Redaksia

Gresa Shehu

Ardora Bilibani

Arta Imeri

Donita Mekaj

Lyra Begolli